



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Njoftim: LISTA E APLIKIMEVE TË PËRFITUESE DHE DOKUMENTET E KËRKUARA PËR MASAT 1-4.

Bazuar në VKM-së nr. 205, datë 30.3.2026, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026” dhe Udhëzimin Nr.8, datë 14.05.2026 i MBZHR dhe MF “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2026”, Kreun VIII “Procedura që ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7 dhe nr. 9.”, përkatësisht pika 3, “Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen on-line, AZHBR shpall brenda 20 ditëve kalendarike, listën e aplikimeve të përfituesve dhe dokumentet e kërkuara sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj www.azhbr.gov.al”, me të dhënat si më poshtë:

- MASA 1: "Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), lopë dhe /ose mëshqerra" janë kualifikuar 6,661 aplikime;
- MASA 2: "Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të të imtave" janë kualifikuar 7,234 aplikime;
- MASA 3: "Për mbarështimin e Bletarisë" janë kualifikuar 7,015 aplikime;
- MASA 4: "Për mbarështimin e dosave/paradosave" janë kualifikuar 269 aplikime;

Të gjitha aplikimet sipas subjekteve/aplikantëve që gjenden në listat e aplikimeve të kualifikuara për masën 1-4 dhe për rastet që kërkohet dokumenti sipas masës përkatëse dhe që kanë nevojë për dokumente shtesë sipas tabelave të mëposhtme, fermerët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente të plota brenda 20 ditëve kalendarike pas publikimit të listave në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë brenda afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.